



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 447/1 prot.

Tiranë, më 18.03.2024

V E N D I M

Nr. 62, Datë 18.03. 2024

Bazuar në nenin 32/1/b dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa nr. 240 Regj., datë 01.11.2023, nga Qendra për të Drejtat e Gruas Rome, përfaqësuar nga znj. M. V (në vijim ankuesja) kundër subjektit privat “Buna Park Hotel” Shkodër, me pretendimin se është diskriminuar për shkak të etnisë.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna, subjekti ankues informon se:

Qendra për të Drejtat e Grave Rome, paraqet këtë ankesë pranë KMD-së ndaj personit juridik “Buna Park Hotel” Shkodër. Ankesa synon të tërheqë vëmendjen ndaj një akti të drejtpërdrejtë të diskriminimit etnik që organizata, Qendra për të Drejtat e Grave Rome, e ka hasur kohët e fundit në fushën e ofrimit të mallrave dhe shërbimeve. Si një organizatë e përkushtuar për fuqizimin e grave rome dhe luftimin e diskriminimit, duke parë të domosdoshme t’ia sjellim këtë çështje në vëmendje Komisionerit.

Qendra për të Drejtat e Grave Rome, është një organizatë jofitimprurëse e themeluar në shtator të vitit 2012 nga një grup grash rome. Stafi i Qendrës përbëhet nga aktivistë me përvojë të gjerë në mbrojtjen e të dejtave të komunitetit rom dhe egjiptian. Misioni kryesor i Qendrës për të Drejtat e Grave Rome, është të fuqizojë, inkurajojë dhe mbështesë gratë dhe vajzat rome, si dhe gratë e tjera që përballen në fusha të ndryshme. Organizata është e përkushtuar për të luftuar kundër të gjitha formave të diskriminimit dhe shfrytëzimit duke promovuar ndërgjegjësimin për rolin e rëndësishëm që luajnë gratë dhe vajzat në shoqëri dhe strukturën e familjes.

Në kuadër të veprimtarisë së saj, organizata jonë kishte planifikuar të organizonte gjatë muajit gusht 2023 një trajnim dy ditor me temë “Festojmë Familjen” për familje rome dhe egjiptiane (gjithësej 45 deri ne 50 individë). Hoteli “Buna Park” Shkodër na u rekomandua nga një tjetër organizatë e respektuar, World Vision, si një vend i përshtatshëm për të mbajtur eventin tonë me prindër dhe fëmijët. Më datën 9 gusht kontaktua në telefon me recepsionisten e hoteli “Buna Park”, Shkodër, (nr.tel.+355 675980233) dhe paraqitëm nevojat tona për akomodim dhe shërbime të tjera të nevojshme për organizimin e trajnimit dyditor. Pas kontrollimit të datave të disponueshme nga ana e saj, ne ramë dakord për datat 17 dhe 18 gusht për të zhvilluar aktivitetin tonë. Gjithashtu ramë dakord që të vijojmë komunikimin me e-mail për specifikat e shërbimeve që na duheshin dhe çmimet përkatëse. Recepsionistja na dërgoi e-mail zyrtar të hotelit (info@bunapark.com).

Në të njëjtën ditë, nga adresa e e-mailit të organizatës sonë, ne i dërguam një e-mail hotelit “Buna Park” Shkodër për të shprehur mirënjohjen tonë për mundësinë e dhënë për të organizuar aktivitetin në ambjentet e tyre dhe kërkua një kuotim për shërbimet e nevojshme për aktivitetin tonë. Duke përmendur se për këtë aktivitet ne mbështetemi financiarisht nga organizata World Vision, me mirësjellje kërkua të mërrnim një ofertë të ngjashme me atë që ata kishin marrë.

Mirëpo, pak më vonë, morëm një telefonatë nga recepsionistja e hotelit, me të cilën kishim komunikuar pak më herët. Ajo pyeti nëse pjesëmarrësit në aktivitetin tonë ishin romë. Pasi konfirmoi se shumica ishin romë, ajo deklaroi se hoteli nuk mund ta pranonte grupin tonë dhe na njoftoi për anulimin e rezervimit.

Kur u pyet më tej, ajo deklaroi se vendimi për të refuzuar rezervimin tonë ishte marrë nga drejtuesit e biznesit. Kërkua të flasim me ta dhe ajo na dha numrin e pronarit, G, për sqarime të mëtejshme. Ne kontaktua G, në numrin +35567..... dhe ai konfirmoi pa rezerva, se hoteli kishte vendosur të mos pranonte asnjë aktivitet që përfshinte romët, për shkak të pretendimeve për dëmtime dhe sjellje të papërshtatshme nga ana e tyre në aktivitete të mëparshme “Nuk e keni idenë sesa dëm më kanë shkaktuar”, vijoi ai. Jo, nuk pranoj më aktivitete me romë. Fëmijët e tyre vendosin duart kudo prishin/dëmtojnë gjërat. Ata nuk dinë të sillen, jo, jo, shtoi ai, duke shmangur pyetjet e mëtejshme.

Ne u përpoqëm të arsyetonim me pronarin, duke theksuar se veprimet e tij ishin diskriminuese, shkelnin parimin e barazisë dhe ishin në kundërshtim me ligjin, i thamë se ai nuk duhet të vendoste “dënim kolektiv” për të gjithë romët për veprimet e ndërmarra nga individë të caktuar. Ne afruam marrjen e masave paraprake, si për shembull ofrimin e një lehtësuesi që mund të kujdesej për fëmijët dhe e sigurova atë se do të mbanim përgjegjësi të plotë për çdo dëmtim të mundshëm. Megjithatë, ai mbeti i palëkundur në qëndrimin e tij diskriminues, duke deklaruar se nuk donte familje rome në biznesin e tij, duke nxituar ta mbyllte telefonatën dhe shpërfillur totalisht përpjekjet tona për ta ndërgjegjësuar mbi parimet e barazisë dhe mosdiskriminimit. I thamë që do të ankohe mi. Ankohuni na tha, dhe e mbylli telefonin.

Ky incident përfaqëson një akt të drejtëpërdrejtë dhe të qartë diskriminimi ndaj organizatës sonë dhe komunitetit rom në tërësi. Vlen të theksohet se ky rast nuk është i izoluar në Shkodër, pasi kemi marrë informacione nga gra rome dhe egjiptiane banuese në Shkodër, të cilat kanë përjetuar diskriminim të ngjashëm nga bizneset në qytet, përfshirë hotelet, restorantet dhe kafenetë. Prandaj mendojmë se ky rast duhet të vij në vëmendjen tuaj.

Përfundimisht, pala ankuese, kërkon nga Komisioneri konstatimin e diskriminimit dhe se veprime të tilla nuk duhet të mbeten pa u ndëshkuar, pasi ato jo vetëm që shkelin parimet themelore të barazisë dhe mosdiskriminimit në marginalizimin e mëtejshëm social. Sanksionimin me gjobë në masën e përcaktuar me ligj të personit juridik “Buna Park” Shkodër. Rregullimin e kuadrit ligjor në sektorin privat të zbatojnë parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit.

Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Referuar Vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me nr.762, datë 14.09.2012, nëpërmjet të cilit Qendra "Për të Drejtat e Gruas Rome", është regjistruar si person juridik dhe është urdhëruar regjistrimi i saj si organizatë jofitimprurëse, me të dhënat përkatëse. (*qëllimi, adresa, veprimtaria, organet drejtuese dhe ekzekutive etj.*) Në bazë të Vendimit nr.762/1 datë 24.10.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka ndryshuar kryetari i Bordit Drejtues, antarët, adresa)

Mbështetur në përmbajtjen e Aktit të Themelimit dhe Statutin e Qendrës, rezulton se forma e organizatës jofitimprurëse, është ajo e Qendrës, parashikuar në ligjin nr. 8788, datë 07.05.2001 “Për organizatat jofitimprurëse” dhe objekti kryesor i veprimtarisë së Qendrës është si më poshtë:

- *“Përmirësimi i statusit të vajzës dhe gruas rome, duke afruar shërbime dhe mbështetje sociale për gratë dhe vajzat duke pasur si prioritet progresin e tyre;*
- *Respektimin e të drejtave të grave si dhe zhvillimi i personalitetit të gruas në mënyrë që të dëgjohet zëri i tyre në familje dhe në shoqëri;*
- *Formulimin e politikave dhe strategjive për të adresuar problemet e gruas rome dhe grave të tjera në pozicione të marginalizuara;*
- *Formulimi i programeve specifike për zhvillim social ekonomik dhe kulturorë të gruas;*
- *Advokaci, lobim kundrejt qeverisë në mënyrë që të marrë masa specifike për të rritur përfshirjen e gruas rome në vendimmarrje;*
- *Krijimin e programeve motivuese të vazhdueshme për rolin e gruas rome në shoqëri dhe integrimin e saj;*
- *Krijimin dhe mbështetje të lidershit të gruas;*
- *Rritjen e sensibilizimit mbi dhunën në familje dhe mjetet mbrojtëse kundër saj;*
- *Promovim të barazisë gjinore;*
- *Të punojë me vajzat që në moshë të hershme duke ju dhënë atyre shance për t'u integruar në jetë;*

- *Të realizojë projekte për qëllimet e mësipëme në mënyrë profesionale dhe me impakte të larta”.*

Bazuar në ankesën e paraqitur, pala ankuese, pretendon se është cenuar në interesin e saj të ligjshëm dhe të drejtëpërdrejtë, si person juridik, pasi i është cenuar e drejta për të marrë shërbime nga subjekti privat .

Bazuar në nenin 32, pika 1, germa “a”, të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet : “1. Komisioneri ka kompetencë: a) të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, siç parashikohet në këtë ligj dhe në ligjin “Për barazinë gjinore në shoqëri”

Bazuar në nenin 4, të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku përcaktohen subjektet e ligjit, parashikohet : “1. Ky ligj zbatohet për të gjithë personat, që jetojnë dhe qëndrojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë. 2. Shtetasit shqiptarë, me banim të përkohshëm ose të përhershëm jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë, gëzojnë mbrojtjen, që ofron ky ligj, në marrëdhëniet me organet shtetërore shqiptare. 3. Personat fizikë e juridikë të huaj, me banim, vendqëndrim apo seli jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, gëzojnë mbrojtjen, që ofron ky ligj, në marrëdhëniet me organet shtetërore shqiptare.”

Bazuar në nenin 32, pika 3, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “3. Për shqyrtimin e ankesave që i drejtohen, komisioneri zbaton normat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, me përjashtim të procedurave që parashikohen nga ky ligj”.

Bazuar në nenin 3, pika 7 dhe 8, të Kodit të Procedurave Administrative, përcaktohet se: “7. “Palë” është: a) çdo person fizik ose juridik, i cili ka të drejtë ose interes legjitim të drejtëpërdrejtë në një procedurë administrative, siç përcaktohet në nenin 33, pika 1, të këtij Kodi; ose b) një palë që nuk ka një të drejtë ose interes legjitim të drejtëpërdrejtë në një procedurë administrative, siç përcaktohet në nenin 33, pikat 2 dhe 3, të këtij Kodi, por që të drejtat ose interesat e saj ligjshëm mund të cenohen nga rezultati i procedurës. 8. Person është çdo person fizik, juridik, si dhe çdo subjekt i së drejtës, sipas legjislacionit në fuqi.”

Referuar nenit 33, pika 1, të Kodit të Procedurave Administrative, përcaktohet se: “1. Palë në procedurën administrative, përveç sa parashikohet në nenin 3, të këtij Kodi, është çdo person: a) me kërkesë të të cilit ka filluar procedura administrative; b) ndaj të cilit ka filluar procedura administrative, ose të cilit i drejtohet apo synohet t’i drejtohet vendimi i procedurës administrative; ose c) me të cilin organi publik synon të lidhë apo ka lidhur një kontratë administrative.....”

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin

seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Në bazë të nenit 7, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën me nr.1223/1 prot., datë 07.11.2023, Komisioneri ka njoftuar dhe kërkuar informacion nga subjekti privat “Buna Park Hotel” Shkodër, si mëposhtë:

- Infomacion mbi pretendimet e ngritura nga ana e znj. M. V, Drejtor Ekzekutiv i Qendës për të Drejtat e Gruas Rome.
- Informacion mbi arsyet e moskonfirmimit të rezervimit të bërë nga ana e Qendës për të Drejtat e Gruas Rome. (*email i datës 09.08.2023*)
- Informacion në lidhje me llojin e aktivitetit të zhvilluar nga Organizata World Vision, data, numri i pjesëmarrëve etj..
- Çdo informacion tjetër që ju do e gjykoni të arsyeshëm se do të ndihmonte në sqarimin e plotë të kësaj çështje.

2. Me shkresën e datë 09.11.2022, "Buna Park Hotel", Shkodër, administruar pranë Komisionerit me nr.1223/2 prot., datë 13.11.2023, ktheu përgjigje duke sqaruar se: “*Në datën që ka kërkuar rezervim subjekti ankues, aktiviteti është në pikun e tij, sidomos rezervimet në hotel dhe ka qenë e pamundur të realizohet akomodimi i këtij grupi, sepse hoteli ka qenë i zënë me klientë të tjerë kryesisht shtetas të huaj. Për arsye të fluksit të sezonit veror, sidomos në gusht dhe për shkak të kapaciteteve të kufizuara, nuk ka mundur të mirëpres Qendrën për të Drejtat e Gruas Rome, në datën e kërkuar në muajin gusht, por që janë të mirëpritur në muaj të tjerë.”*

3. Me shkresën nr. 1223/3 prot date 15.11.2023, të Komisionerit, u kërkua informacion shtesë, duke sqaruar që faktet e parashtruara në kthimin e përgjigjes të vërtetohen me dokumentacion ligjor pëkatës (*fatura tatimore, regjistër etj*), ose çdo dokumentacion tjetër që do e gjykonin të arsyeshëm dhe do të ndihmonte në sqarimin e plotë të kësaj çështjeje.

4. Me shkresën e datës 17.11.2023, administruar pranë Komisionerit me nr.1223/4 prot., datë 30.11.2023 "Buna Park Hotel", Shkodër, ka kthyer përgjigje shkresës së mësipërme të Komisionerit, të shoqëruar me dokumentacionin e kërkuar.

5. Me shkresën nr.1223/5 prot., datë 06.12.2023, i është dërguar ankuesit shkresa e datës 17.11.2023 e subjekti privat "Buna Park Hotel" Shkodër, si dhe dokumentacioni i dërguar me këtë shkresë për të bërë parashtrimet.

- Mbështetur në nenin 33/8, të ligjit 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", të ndryshuar, për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës, Komisioneri me shkresën nr.10, datë 03.01.2024 njoftoi, palët për zhvillimin e seancës dëgjimore me datë 18.01.2024, për të parashtruar dhe argumentuar në mënyrë të drejtpërdrejtë pretendimet e palëve në proces.

Bazuar në nenin 80/1/b të Kodit të Procedurave Administrative dhe Rregullores së Brendshme të Komisionerit, seanca dëgjimore u regjistrua audio dhe përmbajtja e saj do të përdoret si provë gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës.

Seanca u zhvillua në datë 18.01.2024, vetëm me praninë e subjekti ankues, Qendrës për të Drejtat e Gruas Rome, përfaqësuar nga znj. M. V, ndërsa pala kundër të cilit është bërë ankesa nuk u paraqit në seancë.

Duke marrë shkas nga mosparaqitja e subjektit kundër të cilit është bërë ankesa, ai u telefonua nga inspektori i çështjes, të cilit i bëri të ditur se për arsye objektive pjesëmarrja e tij ishte e pamundur. Ndërkohë u shpreh se për këtë rast, në asnjë çast nuk e ka diskriminuar këtë komunitet dhe shpreh keqardhjen për keqkuptimin që ka ndodhur, duke kërkuar ndjesë dhe se ky komunitet dhe jo vetëm, janë përherë të mirëpritur në ambientet e tyre për të kryer çdo aktivitet dhe të marrin shërbimet e tyre. Gjithashtu theksoi se ka patur ndër vite shumë aktivitete me këto komunitete.

Gjatë seancës dëgjimore, përfaqësuesi i subjektit ankues i qëndroi të njëjtave parashtrime të bëra në ankesën e paraqitur para komisionerit.

II. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

Gjatë shqyrtimit të ankesës dhe ndjekjes së procedurës hetimore, Komisioneri në përputhje me parashikimet ligjore ka kërkuar informacionin e nevojshëm dhe dokumentacionin mbështetës, lidhur me rastin e ankueses, në mënyrë që të mund të vlerësonte me objektivitet pretendimin e tij për trajtim të padrejtë dhe diskriminues.

Komisioneri ka përmbushur kërkesat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, edhe sa i takon dhënies së ndihmës efektive, gjë e cila është përcaktuar në nenin 10, të tij: "Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë

në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur. Ai i informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë informacionin e lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre”.

LMD në nenin 32, pikën 2, të tij ka përcaktuar qartë këtë detyrim, duke cituar se: *“Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin Komisionerin, duke i dhënë informacionin që i nevojitet dhe duke i garantuar aksesin në informacion në përmbushjen e detyrave të tij”.*

Nga ana e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi janë marrë të gjitha masat që subjekti kundër të cilit është bërë ankesa të vihet në dijeni për ankesën e bërë dhe i janë ofruar mundësitë që të jepte shpjegime, informacion dhe dokumentacion provues mbi pretendimet e ngritura nga subjekti ankues.

Diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se viktima e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në *“shkakun e mbrojtur”*.

Në nenin 5, pika 1, të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar përcaktohet se: *“1. Ndalohet diskriminimi për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe mosmarrja në shqyrtim, sipas rasteve të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, e një ankimi ose procedurë, si dhe çdo formë tjetër sjelljeje që pengon zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë”.*

Në Kreun IV, të LMD-së parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e të mirave dhe shërbimeve. LMD në nenin 20/1/a dhe b¹, ndalon çdo lloj dallimi, kufizimi ose përjashtimi, që i bëhet një personi apo grupi personash në ofrimin e të mirave dhe shërbimeve.

Ligji 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, ndalon diskriminimin që bazohet në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, pra edhe për shkak të etnisë dhe që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Një nga format e diskriminimit parashikuar nga ligji, është diskriminimi i drejtpërdrejtë, i cili përkuqizohet nga neni 3/2, i ligjit si një situatë diskriminimi që ndodh kur një person ose grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, ose një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji.

¹ Neni 20/1/a dhe b, të ligjit 10221/2010: *“Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t’i arrijë ose t’i përdorë ato: a) duke refuzuar t’i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji; b) duke refuzuar t’i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi...”*

Nga analiza e provave dhe fakteve të administruara rezultoi e provuar se nga ana e znj. M. V, në cilësinë e drejtorit Ekzekutiv të Qendrës për të Drejtat e Gruas Rome, është zhvilluar një bisedë telefonike midis saj dhe reçpionistes së Hotelit Buna Park Shkodër (*pranuar nga të dyja palët*).

Në vijim të komunikimit të mësipërm, nga ana e ankueses, nëpërmjet e-mailit të datës 09 Gusht 2023, me adresë, romawomanrights@gmail.com, drejtuar në adresën e-mail, Info@bunapark.com, është kërkuar si vijon: *“Përshëndetje! Ju faleminderit për bisedën që patëm dhe mundësinë që na afruat për ta zhvilluar aktivitetin tonë në ambientet tuaja. Ashtu siç folëm paraprakisht ne kemi planifikuar një aktivitet dy ditor me rreth 15 familje (prindër e fëmijë) rreth 45-50 veta. Ky aktivitet financohet nga Word Vision dhe to ju luteshim që të na afroni të njëjtën ofertë që operoni me ta.”*

Në përgjigje të e-mailit të mësipërm nga subjekti privat “Buna Park Hotel” Shkodër, në datën 10 Gusht 2023, është kthyer përgjigje, me këtë përmbajtje: *“Uroj të jeni mirë! Me vjen keq por ne nuk mund ta konfirmojmë këtë rezervim. Shpresoj të na mirëkuptoni. Ju faleminderit!”*

Me shkresën e datë 09.11.2022, subjekti privat “Buna Park Hotel” Shkodër, ka sqaruar Komisionerin se: *“Në datën që ka kërkuar rezervim subjekti ankues, aktiviteti është në pikun e tij, sidomos rezervimet në hotel dhe ka qenë e pamundur të realizohet akomodimi i këtij grupi, sepse hoteli ka qenë i zënë me klientë të tjerë kryesisht shtetas të huaj. Për arsye të fluksit të sezonit veror, sidomos në gusht dhe për shkak të kapaciteteve të kufizuara, nuk ka mundur të mirëpres Qendrën për të Drejtat e Gruas Rome, në datën e kërkuar në muajin gusht, por që janë të mirëpritur në muaj të tjerë.”*

Pretendimet e mësipërme subjekti i ka mbështetur duke dërguar prova shtesë të kërkuara nga Komisioneri dhe ka sjellë: 1. Grafikon e prenotimeve nga data 1 gusht deri me 31 gusht. 2. Xhiron ditore për datat 17-18 gusht 2023. 3. Xhiron ditore sipas operatorëve me data 17-18 gusht 2023.

Duke marrë shkas nga mosparaqitja në seancën dëgjimore e zhvilluar në datën 18.01.2024 të subjektit "Buna Park Shkodër", për të sqaruar situatën dhe çdo pretendim të ngritur nga pala ankuese, nga ana e Komisionerit me e-mailin e datës 23.01.2024, është kërkuar informacion shtesë lidhur me rastin.

Me e-mailin e datës 24.01.2024, nga ana e nga ana e subjekti privat “Buna Park Hotel” Shkodër, është kthyer përgjigje dhe është dërguar dokumentacion ku janë të pasqyruar disa nga aktivitetet e zhvilluara me fëmijët e Komunitetit Rom, sipas kontratave të shërbimit me disa shoqata si World Vision Albania, shoqata "Fjala", shoqata "Shpresë për Botën". Ky informacion është i shoqëruar me, kontratën e shërbimit të lidhur me shoqatën "World Vision Albania", faturat tatimore të shërbimit sipas porosive, foto me imazhe që tregojnë aktivitete me fëmijët e këtij komuniteti në ambjentet e këtij subjekti.

World Vision është një organizatë ndërkombëtare humanitare e krishterë, zhvillimi komunitar dhe advokatie. Në Shqipëri, World Vision ka filluar të punojë në 1999-ën, si përgjigje ndaj krizës

së refugjatëve kosovarë. Prej dy dekadash, puna e tyre është fokusuar te zhvillimi dhe mbështetja afatgjatë për fëmijët, të rinjtë dhe familjet më në nevojë. Mbështesin dhe punojnë për fuqizimin e fëmijëve, familjeve dhe komuniteteve më në nevojë. Mbrojtja e përfshirja sociale, aktivizmi rinor dhe mundësitë e zhvillimit ekonomik për familjet më në nevojë janë fokusi i punës tyre. World Vision angazhohet për të sjellë ndryshim të qëndrueshëm dhe rritjen e mirëqenies për fëmijët dhe familjet në Shqipëri.

Gjithashtu subjekti privat "Buna Park Hotel" Shkodër, sqaroi se nuk ka tendenca për diskriminim ndaj asnjë komunitetit ekzitues në Republikën e Shqipërisë, gjithashtu gra që i përkasin komunitetit Rom, janë të punësuar me kontrata të rregullta, të siguruara dhe të deklaruara në Zyrën e Punës, pretendime të cilat arriti ti provonte me fakte konkrete të cilat iu vunë në dispozicion Komisionerit.

Informacioni i mësipërm iu vu në dispozicion ankueses për të bërë parashtrimet e saja, e cila me e-mailin e datës 24.01.2024, ka parashtruar se: *“Unë mbetem me qëndrimin se përveç ndjesës së ofruar me telefon mua edhe ju, bisnezi duhet të ndërmerret disa angazhime që tregojnë vërtet ai ka reflektuar si p.sh: Dërgimin e një emaili të përbashkët organizatës tonë dhe organizatave të tjera ku tregon gadishmërinë për të na mirëpritur në aktivitete me pjesëmarrjen e individëve romë (të monitorohet në 6 muaj); Nxjerrjen e një njoftimi/postimi publik ku tregon se bisnezi zbaton parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit në shërbimet që ofron; Zhvillimin e një trajnimit për stafin mbi ligjin "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi" (stafi juaj të lektorojë); Apo çdo veprim tjetër që ju e shikoni relevant ta rekomandoni.”*

Me e-mailin e datës 22.02.2024, subjekti privat “Buna Park Hotel” Shkodër, i është drejtuar Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Qendrës për të Drejtat e Gruas Rome, duke shprehur si më poshtë vijon:

“Përshëndetje të Nderuar!

Duke shprehur konsideratën tonë me të lartë, për punën Tuaj, bashkëpunimin dhe ndërgjegjësimin për çështje kaq të ndjeshme të shoqërisë shqiptare, shprehim keqardhjen tonë lidhur me rastin e ankesës së bërë nga ana e Qendrës për të Drejtat e Gruas Rome.

Shoqëria jonë në lidhje me aktivitetin që ushtron është një shoqëri që vlerëson dhe ka në parim bazë të saj gjithëpërfshirjen, diversitetin, barazinë dhe mosdiskriminimin, duke siguruar shërbime të barabarta pa përjashtim, kufizim apo preferencë.

Qendra për të Drejtat e Gruas Rome por dhe çdo subjekt tjetër privat apo juridik në Republikën e Shqipërisë por jo vetëm pa kufizim janë përherë të mirëpritur në ambientet tona për të marrë shërbimet me të mira nga ana jonë dhe jemi të predispozuar për të dhënë një shërbim sa me të mirë, cilësor dhe të kënaqshëm.

Gjithashtu, shoqëria jonë është e gatshme që në çdo moment të vihet në shërbim të çdo qytetari pa dallim race, etnie, ngjyre, gjuhe, shtetësie etj...

Po ashtu në kuadër të ndërgjegjësimit jemi të hapur që nga ana juaj të na afrohet ndihmë profesionale për trajtimin e stafit tonë që mos të ketë asnjëherë raste të keqkuptimit apo të ndonjë sjellje diskriminuese ndaj qytetarëve.”

Në vijim të e-mailit të mësipërm, nga ana e Qendrës për të Drejtat e Gruas Rome, në datën 06.03.2024, është KMD-së i është dërguar e-mail me anë të cilit është shprehur se:

“Përshëndetje të nderuar,

Ju falenderoj për ndjekjen rigorozisht nga zyra juaj të ankesës për diskriminim, paraqitur nga Qendra jonë përkundrejt subjektit “Buna Park Hotel”, në Shkodër.

Duke qenë se tashmë falë komunikimeve të lehtësuara nga zyra juaj është bërë e mundur që biznesi në fjalë të ndërgjegjësohet për shkeljen e bërë, të kërkojë ndjesë, dhe të angazhohet që t'i ofrohet trajnim stafit të tij në mënyrë që situata të tilla të mos ndodhin asnjëherë më, ju bëjmë me dije së heqim dorë nga ankesa jonë.

Lutemi që nga zyra juaj të ndiqet respektimi i angazhimeve të marra dhe gjithashtu rekomandimeve të dhëna nga zyra juaj. Ne jemi të hapur të bashkëpunojmë me zyrën tuaj e të krijojmë facilitete për zhvillimin e trajnimeve për stafin e këtij biznesi apo subjekteve të tjera që kanë rekorde të sjelljes diskriminuese ndaj anëtarëve të minoritetit rom dhe egjiptian.”

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se, qëllimi për të cilin ishte filluar hetimi administrativ është përmbushur në thelb, dhe në referencë të nenit 33, pika 9, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet se: “Kur e sheh të përshtatshme, Komisioneri kërkon të arrijë marrëveshje pajtimi mes ankuesit dhe personit kundër së cilit është paraqitur ankesa”, KMD vlerëson se është arritur efektiviteti dhe qëllimi për të cilin ishte iniciuar ankesa.

Në nenin 90/3 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” parashikohet përfundimi i procedurës administrative: “Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrativ”.

Njëkohësisht, në referencë të nenit 94/1, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon se: “Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë”, Komisioneri deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 90/3 dhe 94/1, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenin 1, nenin 7, pika 1, neni 20 dhe 21, pika 1, nenin 32, pika 1, shkronja a) e nenin 33, pikat 9-10, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative për shqyrtimin e ankesës nr. 240, datë 01.11.2023, të paraqitur nga Qendra për të Drejtat e Gruas Rome, përfaqësuar nga znj. M. V, pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin kishte filluar procedura hetimore.
2. Subjekti privat “Buna Park Hotel” Shkodër të marrë masa për të rritur ndërgjegjësimin për ligjin nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, duke e afishuar atë në mjediset publike të tij, si dhe të realizojë trajnime për stafin/punëmarrësit, për të mundësuar kuptimin e plotë të ligjit, si dhe respektimin e zbatimin me efektivitet të tij.
3. Bazuar në nenin 33 pika 11, të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, subjekti privat “Buna Park Hotel” Shkodër, detyrohet që brenda 30 (tridhjetë) ditëve të njoftojë Komisionerin, lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijëni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Hartoi: L. Jani
Rishikoi: R. Hoxha
Miratoi: V. Bushati
Datë: 07.03.2024

